

natë. Po atë ditë, familja e tij e ka braktisur Dobroshecin/Dobroševac për shkak të sulmit të forcave serbe. Për pesë ditë rresht, familjarët nuk kishin kurrfarë njohuri për fatin e Hazirit. Disa ditë më vonë, i vëllai Aliu e ka gjetur trupin e pajetë të Hazirit në vendin e quajtur *Gaspojë/Gaspoje* [Dobroshec/Dobroševac]. Trupi i Hazirit ka qenë i shtrirë në afërsi të trupit të Rifat Fejzës [të shikohet regjistrimi]. Hazirin e kishin vrarë me një plumb në kokë. Po atë ditë, e varrosën në varrezat e *Mëhallës Shishman* në Dobroshec/Dobroševac.

Burimet: deklarata N.F, FDH-17188; deklarata M.A, FDH-17187.

Limani (Selman) Krasniqi

(30.12.1931, shqiptar nga Gllanasella/Gladno Selo, komuna e Gllgocit/Glogovac, bujk, nëntë fëmijë)

Limani Karaqica me bashkëshorten Gjiziden dhe katër fëmijë kaluan në Maqedoni në vitin 1968. Atje, ata e kishin adoptuar mbiemrin Krasniqi. Pas gjashtë muajsh, ata u kthyen në **Gllanasellë/Gladno Selo**. Bashkëshortja i ndërroi jetë pas kthimit në Kosovë dhe Limani u rimartua me Adilen. Me të pati pesë fëmijë.

Pas ngjarjeve në Likoshan/Likošane më 28.02.1998 [të shikohet regjistrimi] dhe Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze [të shikohet regjistrimi], Limani të shumtën e kohës rrinte i fshehur nëpër male dhe kthehej në shtëpi vetëm në mbrëmje për ta kaluar natën. Në datën **21.09.1998**, Limani erdhi në shtëpi për herë të fundit. Dy ditë më vonë, familja e Limanit, së bashku me bashkëfshatarë të tjerë, e braktisi shtëpinë e vet. Disa ditë më vonë, familjarët mësuan se Limanin e kishin vrarë më 23.09.1998. Trupin e tij e kishin gjetur në një fushë afër pyllit të fshatit. Një ditë më vonë, e varrosën jo larg nga vendi i vrasjes. Pas përfundimit të luftës, mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në varrezat familjare në Gllanasellë/Gladno Selo.

Burimi: deklarata A.K, FDH-35224.

Hafize (Islam) Llugani

(3.2.1930, shqiptare nga Gllanasella/Gladno

Selo, komuna e Gllgocit/Glogovac, një fëmijë)
Familja Llugani e ka braktisur fshatin Gllanasellë/Gladno Selo më 21.09.1998. U strehuan në Krasmiroc/Krasmirovac, ku në shtëpinë e vet i ka pranuar Rexhep Bunjaku. Në natën mes datave **21** dhe **22.09.1998**, Hafizja, e cila vuante nga çrregullimet psikike, doli nga shtëpia e Rexhepit dhe nuk u kthye më. Pas disa ditësh, familja e saj u kthye në Gllanasellë/Gladno Selo. Menjëherë pas kthimit, familjarët mësuan se në **Likoshan/Likošane** ishte gjetur trupi i pajetë i një gruaje. Nipi i Hafizes, Arifi, ka shkuar menjëherë atje dhe në *Mëhallën Neziri* ka mësuar se bëhej fjalë për trupin e gjyshes së tij. Në shpinë i kishte plagët nga plumbat. Hafizen e kanë varrosur në varrezat e *Mëhallës Llugani* në Gllanasellë/Gladno Selo.

Burimi: deklarata A.L, FDH-17203.

Hasan (Fetah) Maloku

(1928, shqiptar nga Dobrosheci/Dobroševac, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor, pesë fëmijë)

Hasani punonte si shtëpiak në shkollën fillore të **Dobroshecit/Dobroševac**. Forcat serbe kanë hyrë në fshat më **22.09.1998**. U strehuan në godinën e shkollës. Banorët i braktisën shtëpitë e veta dhe u strehuan në bjeshkën e afërt. Hasani me bashkëshorten Fazën kanë vendosur të rrinin në shtëpinë e vetë. Po atë ditë, Hasanin e plagosën rëndë përderisa ishte duke ndenjtur me shoqen në dhomë. Një plumb i shkrepur nga drejtimi i shkollës fillore e ka qëlluar Hasanin në stomak dhe në dorën e djathtë. Ka dhënë shpirt nga plagët e rënda pesë ditë më vonë, më 27.09.1998. Po atë ditë, djali i Hasanit, Nazmiu, me ndihmën e disa bashkëfshatarëve, e ka varrosur të atin në varrezat e Dobroshecit/Dobroševac.

Burimi: deklarata F.S, FDH-17185.

Slobodan (Mihajlo) Gorjanović

(27.12.1970, serb nga Novi Sadi, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas trajnimit të mbaruar për oficer policie, Slobodani u punësua në MPB-në e Serbisë në muajin tetor të vitit 1992. Punonte në